

## TRAJNIM PËR ARKEOLOGJINË NËNUJORE DHE DIGJITALIZIMIN E PASURISË KULTURORE NËNUJORE

Në një atmosferë bashkëpunimi ndërkombëtar dhe përkushtimi ndaj trashëgimisë kulturore, në Ulqin nisi trajnimi për Arkeologjinë Nënujore dhe Digjitalizimin e Pasurisë Kulturore Nënujore, ku morën pjesë edhe 4 specialistë të IKTK.

Dita e parë e workshop-it përfshiu:

- Prezantimin e programit dhe objektivave të trajnimit
- Njohjen me Qendrën Ndërkombëtare për Arkeologjinë Nënujore në Zadar
- Ligjërata mbi historinë dhe metodologjitë e përdorura në arkeologjinë nënujore
- Ushtrime praktike për dokumentimin 2D të gjetjeve me metoda tradicionale grafike

Ky trajnim shënon një hap të rëndësishëm drejt përmirësimit të kapaciteteve profesionale në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë nënujore shqiptare.

Ky aktivitet u organizua nga Qendra Ndërkombëtare për Arkeologjinë Nënujore e UNESCO-s në Zadar, Kroaci, në bashkëpunim me Universitetin e Malit të Zi, në kuadër të programit IPA për Adriatikun Jugor.



# BANESA MAK HAXHISTASA, BERAT

Specialistë nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK) realizuan një inspektim në terren në qytetin e Beratit për të dokumentuar gjendjen ekzistuese të Banesës Mak Haxhistasa, Monument Kulture i kategorisë së parë.

Ky inspektim synoi vlerësimin e nevojave të ruajtjes së monumentit dhe grumbullimin e të dhënave të domosdoshme për hartimin e një projekti të plotë restaurimi.



# DITA NDËRKOMBËTARE E MONUMENTEVE DHE SITEVE

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Monumenteve dhe Siteve - 18 Prill, me temën e propozuar nga ICOMOS për vitin 2025: “Disaster and Conflict Resilient Heritage”, znj. Joli Mitrojorgji, Drejtoreshë e Përgjithshme e IKTK, mbajti një leksion informues në Universitetin Politeknik të Tiranës me studentët e Arkitekturës. Ky takim u fokusua në rëndësinë e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore përballë fatkeqësive natyrore dhe konflikteve. Studentët patën mundësinë të njihen më thellë me sfidat e ruajtjes së trashëgimisë dhe rolin që ata mund të luajnë në të ardhmen si profesionistë të fushës.



# INSPEKTIME NË TERREN

Në vijim të punimeve restauruese që po zhvillohen në kuadër të projekteve për ruajtjen e trashëgimisë sonë kulturore, specialistët e IKTK-së kryen inspektime në Kishën e Shën Marisë në Bishqethëm dhe në Manastirin e Ardenicës në Lushnje.

Gjatë këtyre inspektimeve u vlerësua ecuria e ndërhyrjeve restauruese, të cilat synojnë të rikthejnë dhe të ruajnë vlerat historike, arkitektonike dhe shpirtërore të këtyre monumenteve të rëndësishme të kultit.



# OBJEKTE ARKITEKTONIKE NË BAZILIKËN PALEOKRISTIANE EXTRA MUROS, ELBASAN

Objekte arkitektonike në Bazilikën Paleokristiane Extra Muros Elbasan.

Kapitele mermeri me forma të ndryshme, kolona, bazamente kolonash, pllaka të pjesës së altarit, dhe elementë që kanë qenë pjesë e dritareve - janë disa nga objektet arkitektonike të zbuluara në Bazilikën Paleokristiane Extra Muros.

Të realizuara me mermer cilësor, i ardhur nga brigjet e detit Marmara, Azia e Vogël dhe ishujt e Egjeut, këto elementë arkitektonikë dëshmojnë një nivel të lartë artistik dhe një zhvillim të dukshëm ekonomik të periudhës në të cilën bazilika funksiononte.



# MOTIVE NGA BANESAT NË ELBASAN

Karakteristikë e ndërtimit të banesave të dikurshme të ndërtuara në Elbasan, siç janë banesat e tipit me çardak, ka qenë përdorimi i drurit në ndërtimin e banesës dhe zbukurimin e brendshëm të saj.

Elementin dru e gjejmë të përdoret kudo. Përdoret në dyer të jashtme dhe të brendshme, korniza dritarësh, mure, tavane, mbajtëset e shkallarëve, dollapë, sëndukë, dysheme, tavolinat e ngrënies, lugë, etj. Motivi kryesor i zbukurimit të drurit ka qenë motivi floreal, element i përdorur edhe në afresket e shtëpisë.

